

Kids Athletics, 28 Mars 2019

Më datë 28 Mars 2019, Federata Shqiptare e Atletikës organizoi aktivitetin e radhës për "Kids Athletics" në shkollën "Dora D'Istria" në Tiranë.

Aktiviteti filloi në orën 10:00 të paradites, ku mësues të certifikuar nga IAAF (Federata Botërore e Atletikës) si dhe FSHA, zhvilluan modulën e Atletikës për fëmijë për nxënësit e kësaj shkolle.

Në këtë aktivitet, krahas dy krerëve të FSHA-së, z.Gjergj Ruli (President) si dhe z.Nikolin Dionisi (Sekretar i Përgjithshëm), mori pjesë gjithashtu dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, i cili mbështeti nismën e Federatës Shqiptare të Atletikës për zhvillimin dhe promovimin e sportit tek brezat e rinj nëpër shkolla.

Gjithashtu të pranishëm ishin dhe përfaqësuesja e Ministrisë së Arsimit të Sportit dhe Rinisë znj. Elvira Baze si dhe drejtori i Drejtorisë Arsimore Rajonale të Tiranës z.Redian Dengeri si dhe atleti rekordmen Izmir Smajlaj.







TABELA E REZULTATEVE

NGJYRAT:	FORMULA UNO	STAFETË	KËRCIM KRYQ	TOP NË SHENJË	TOP MEDIS	KËRCIM NGA VENDI	PIKËT
<u>E KUQE</u>	1.00" 4	1.14 5	16 4	17 4	35p 3	15 1	21p 3
<u>E VERDHE</u>	1.04" 3	1.32" 3	15 1	15 1	36p 4	16 2	14p 5
<u>JESHILE</u>	59".08 5	1.34" 2	15 1	17 4	37p 5	19 6	23p 2
<u>BLU</u>	51" 6	50" 6	18 6	22pm 6	38p 6	18 5	35p 1
<u>PORTOKALLI</u>	1.13" 1	1.30" 4	16 4	16 2	35p 3	17 4	18p 4
<u>ROZË</u>	1.06" 2	1.35 1	17 5	18m 5	34p 1	17m 4	18p 4